

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Geci” shpk
Adresa: Tirana International Hotel, Sheshi Skënderbej, Nr. 8,
Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rehabilitim i varrezave Sharrë dhe lidhja me rrugën ekzistuese Kombinat”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rehabilitim i varrezave Sharrë dhe lidhja me rrugën ekzistuese Kombinat”.

Fondi limit: 276,886,912 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve me Vendimin Nr. 31, datë 13.06.2016 “Për shpërndarjen e financimit për projekte të Grantit “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”, Programi “Zhvillimi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale”, Shtylla I, Thirrja II, për vitin 2016”, rialokuar me shkresën me Nr. 2083 Prot. datë 06.03.2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën me Nr. 9194 Prot. datë 08.03.2017.

Kohëzgjatja e kontratës: 28 (njëzetë e tetë) javë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 11.01.2017, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 51 datë 27.12.2016.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Junik” shpk

NUIS J68007522L

Vlera e ofertës = 0 (zero) lekë.

2. Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk

NUIS J61905050M

Vlera e ofertës = **200,650,296** (dyqind milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Alb-Star” shpk

NUIS J620903512W

Vlera e ofertës = **215,783,109.2** (dyqind e pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e nëntë pikë dy) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “N.T.P. Eurokos” Degë e shoqërisë së huaj & “Denis-05” shpk

NUIS L04803001U & NUIS K51518029B

Vlera e ofertës = **219,987,954.90** (dyqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj

NUIS K91326028I

Vlera e ofertës = **229,246,311** (dyqind e njëzetë e nëntë milion e dyqind e dyzetë e gjashtë mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “Geci” shpk

NUIS K71829801O

Vlera e ofertës = **270,931,893.75** (dyqind e shtatëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “Bami” shpk

NUIS J944162006R

Vlera e ofertës = **273,718,178** (dyqind e shtatëdhjetë e tre milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Operatori ekonomik “Junik” shpk

NUIS J68007522L

- Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Junik” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.
- Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk

NUIS J61905050M

- Shoqëria “Euroteorema Peqin” shpk referuar QKR rezulton se ka një adresë të ushtrimit të aktivitetit të saj edhe në Tiranë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Shoqëria “Euroteorema Peqin” shpk nuk ka parqitur Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Bashkia Tiranë për vitin 2016, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 3 në të cilën përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë: 3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2016; 3.1 Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR.”*
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se listpagesat e punonjësve të paraqitura nga Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk për periudhën Nëntor 2015 – Nëntor 2016 nuk janë sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, pasi nuk janë të shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit, Kapaciteti Teknik, pika 4, gërma “b”.
- Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar pranë shoqërisë 2 (dy) teknik ndërtimi të pajisur me dëshmi kualifikimi lëshuar nga ISHTI, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Për sa më lart, shoqëria nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 7, çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se:
*Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha krëteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....***
*b)Aftësia teknike ;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,..reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe **personelin e nevojshëm** për të zbatuar kontratën.....*
- Gjithashtu Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk ka paraqitur ISO 9001-2008; ISO 14001-2004; OHSAS 18001-2007; ISO 39001-2012; PASS 99-2012 dhe ISO 50001-2011 në gjuhë të huaj dhe s’janë të shoqëruara me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, çka bie në kundërshtim me DST, Njoftimi i kontratës, pika 4.6.

3. Operatori ekonomik “Alb-Star” shpk

- Referuar pikës 7 “Kapaciteti Teknik”, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të lëshuar nga ISHTI, kontratë pune të vlefshme si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, për punonjësit me kualifikime si më poshtë: 3 (tre) punonjës elektrikist; 3 (tre) punonjës hidraulik; 2 (dy) teknik ndërtimi.”* Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori ekonomik “Alb Star” Shpk nuk ka paraqitur kontratat e punës për asnjë nga punonjësit e deklaruar me dëshmi kualifikimi të lëshuar nga ISHTI përkatësisht për punonjësit elektrikist, hidraulik dhe teknik ndërtimi.
- Gjithashtu Operatori ekonomik “Alb Star” Shpk nga 3 (tre) punonjës elektrikist të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit, Krite të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7 ka paraqitur dokumentacionin vetëm për 2 (dy) punonjës me profil elektrikist. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se janë paraqitur dhe dokumente për 2 (dy) punonjës me profil ing elektrik por që kualifikimi i tyre nuk është sipas kërkesës së pikës 7 Kapaciteti Teknik ku përcaktohet se “Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të lëshuar nga ISHTI, kontratë pune të vlefshme si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, për punonjësit me kualifikime si më poshtë: 3 (tre) punonjës elektrikist”.
- Për sa më lart, shoqëria nuk zotëron kapacitetet e mjaftueshme teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këte objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 7, çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se:
Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....
b)Aftësia teknike ;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.....
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacion shoqëruar për stafin teknik të deklaruar nga Operatori ekonomik “Alb-Star” shpk, konstatoi se Libreza e Punës e Ing. Elektrik nuk është e plotë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Dokumenti OHSAS 18001-2007 i paraqitur nga shoqëria “Alb-Star” shpk nuk mban firmën e noterit, përkatësisht dokumenti Vërtetim me Nr. 15 Rep., datë 04.01.2017 “Vërtetim”, nuk është i firmosur nga noteri, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11 ku përcaktohet se *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007 (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS).”*

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “N.T.P. Eurokos” Degë e shoqërisë së huaj & “Denis-05” shpk

NUIS L04803001U & NUIS K51518029B

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Ekstrakti mbi Historikun e subjektit i paraqitur nga shoqëria “N.T.P. Eurokos” Degë e shoqërisë së huaj nuk është i plotë, pasi mungon faqja Nr. 5, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit, pika 1 në të cilën ndër të tjera përcaktohet se: *“Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: Një dokument që vërteton se (subjekti juaj): a)nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv) b)nuk është dënues për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP, c)nuk është dënues me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional, Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 11 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore...”*
- Operatori ekonomik “Denis-05” shpk ka deklaruar se disponon 7 (shtatë) manovrator. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqëruar për manovratorët e deklaruar, konstatoi se kontratave të punës të lidhur me punonjësit e sipërcituar u ka përfunduar afati i vlefshmërisë më datë 05.01.2017, ndërkohë që data e zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Rehabilitim i varrezave Sharrë dhe lidhja me rrugën ekzistuese Kombinat” ka qenë data 11.01.2017.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk disponon 7 (shtatë) manovrator, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 8 në të cilën përcaktohet se: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 7 (shtatë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.”*
- Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk zotëron kapacitetet e mjaftueshme teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këto objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 8, çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se:
Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha krëteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....
b)Aftësia teknike ;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.....

5. Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj

NUIS K91326028I

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se listpagesat e punonjësve të paraqitura nga Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj për muajt Tetor 2016 dhe Nëntor 2016 nuk janë sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, pasi nuk janë të shoqëruara me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, cka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit, Kapaciteti Teknik, pika 4, gërma “b”.
- Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj ka lidhur në Tiranë kontratën e punës me mjekun e përgjithshëm Z. Sherif Fusha më datë 01.08.2014, por nuk ka paraqitur Librezën e Punës për mjekun e sipërcituar, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Referuar Deklaratës mbi disponueshmërinë e mjeteve, Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj ka deklaruar se disponon 4 (katër) Kamion vetshkarkues përkatësisht me targa 01-751-EO; 01-574-EO; 01-835-XB dhe 01-752-EO. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqëruar për mjetet e deklaruar si më lart konstatoi se në bazë të Çertifikatës së regjistrimit të automjetit si dhe Policës së sigurimit, mjeti me targë 01-835-XB rezulton të jetë gjysëm rimorkio dhe jo Kamion vetshkarkues ashtu siç është deklaruar sipas Shtojcës 9.
- Për sa më lart shoqëria “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj disponon 3 (tre) Kamiona Vetshkarkues, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, 15 në të cilën ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 4 (katër) Kamiona vetshkarukes (kapaciteti mbajtës minimum 25 ton)”*.
- Nga verifikimi i bërë Shtojcës 9, rezulton se Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj nuk ka deklaruar se disponon Rul me goma, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DST, Kapaciteti Teknik, pika 15.
- Sa më sipër, Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj nuk ka kapacitetin e duhur teknik për objektin që prokurohet, pasi nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

6. Operatori ekonomik “Bami” shpk

NUIS J944162006R

- Shoqëria “Bami” shpk ka paraqitur kontratat e ngjashme me objektin e prokurimit si më poshtë vijon:
 - 1-“Rikonstruksion i rrugës Durrës - Fushë Krujë” ku shoqëria “Bami” shpk ka qenë në bashkëpunim me shoqërinë “Curri” shpk.Vlera e kontrates është 88,028,797 lekë pa TVSH.Shoqëria “Bami” shpk në bazë të përqindjes së partneritetit (90 %) i takon vlera e realizimit të kontratës në masën 79,225,917 lekë pa TVSH.
 - 2- “Riparim shtrese asfaltike në rrugën Nr. 02, Segmenti Vorë-Marikaj-Nish-Tulla (e vjetra)” me vlerë të kontratës 30,775,320 lekë pa TVSH.
 - 3-“Rikonstruksion i rrugës Lagjia Demokracia” me vlerë të kontratës 11,524,700 lekë pa TVSH.
 - 4-“Ndërtim i kanalizimeve të ujërave të zeza, Loti I: Ndërtim i kolektorit të ujërave të zeza, Fushë-Mamurras” me vlerë të kontratës 16,317,496 lekë pa TVSH.
 - 5-“Asfaltim i rrugës Mimosave në Kodër Vorë, Bashkia Vorë, përballë godinës Bashkisë Vorë” me vlerë të kontratës 8,254,770 lekë pa TVSH.
 - 6-“Sistem-Asfaltimi i dy segmenteve të rrugës Rilindja Fshati Marqinet Segmenti 1 dhe 2, Bashkia Vorë” me vlerë të kontratës 9,155,000 lekë pa TVSH.
 - 7-“Sistemim asfaltim Rrugës Bashkimi Vorë, Bashkia Vorë, (Lidhja e rrugës Kodra e Bukur me rrugën Fusha e Sportit)” me vlerë të kontratës 7,798,750 lekë pa TVSH.
 - 8-“Riparim i shtresave rrugore, Bashkia Vorë” me vlerë të kontratës 3,132,244 lekë pa TVSH.
 - 9-“Veshje asfaltike të rrugëve Nozllak, 17 Nëntori, 5 Dëshmorët, Gani Toptani, 3 Dëshmorët” ku shoqëria “Bami” shpk ka qenë në bashkëpunim me shoqërinë “Almo Konstruksion” shpk.Vlera e kontrates është 30,070,300 lekë pa TVSH.Shoqëria “Bami” shpk në bazë të përqindjes së partneritetit (55 %) i takon vlera e realizimit të kontratës në masën 16,538,665 lekë pa TVSH.
 - 10-“Rikonstruksion i rrugës Porcelan-Kinostudio-Surrel” me vlerë të kontratës 63,333,333 lekë pa TVSH.
 - 11-“Sistemim dhe ndricim i rrugës së Malit, Rruga Kalaja” me vlerë të kontratës 13,180,790 lekë pa TVSH.
 - 12-“Rikonstruksion i rrugës Piro Goda” me vlerë të kontratës 26,338,386 lekë pa TVSH.
- Sa më sipër konkludohet se Operatori ekonomik “Bami” shpk në lidhje me kontratat e mësipërme të paraqitura për të vërtetuar përvojën e sukseshme nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1/a për një objekt të vetëm në vlerën **138,443,456** lekë pa TVSH si edhe pikën 1/b pasi shumatorja e të gjitha kontratave të

ngjashme të paraqitura nga ky Operator ekonomik është **285,575,371** lekë pa TVSH duke mos kapur vlerën **553,773,824** të kërkuar sipas DST.

- Në këtë mënyrë shoqëria “Bami” shpk nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1 cka bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 46, pika 1 gërma “b” si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 6.
- Operatori ekonomik “Bami” shpk ka deklaruar si Ing. Mjedisi Z. Xhemil Dalipi. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Bami” shpk nuk ka paraqitur CV për Inxhinierin e sipërcituar, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për punonjësit e pajisur me Dëshmi Kualifikimi lëshuar nga ISHTI, konstatoi se Operatori ekonomik ka të punësuar pranë shoqërisë 2 (dy) punonjës elektrikist; 2 (dy) punonjës hidraulik si dhe 1 (një) teknik ndërtimi, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7 në të cilën ndër të tjera përcaktohet se: *“...Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ketë të punësuar pranë shoqërisë **3 (tre) punonjës elektrikist; 3 (tre) punonjës hidraulik si dhe 2 (dy) teknik ndërtimi...**”*.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për manovratorët konstatoi se: Shoqëria “Bami” shpk ka të punësuar pranë shoqërisë 4 (katër) punonjës manovrator, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8 në të cilën ndër të tjera përcaktohet se: *“...Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ketë të punësuar **7 (shtatë) punonjës manovrator të mjeteve të rënda...**”*.
- Gjithashtu KVO konstatoi se shoqëria “Bami” shpk nuk ka paraqitur dëshminë e drejtimit (të vlefshme) për Z. Artan Caca i punësuar si manovrator, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8.
- Për sa më lart, shoqëria nuk zotëron kapacitetet e mjaftueshëm teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 7 dhe pika 8, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se:
*Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....***
*b)Aftësia teknike ;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe **personelin e nevojshëm** për të zbatuar kontratën.....*
- Operatori ekonomik “Bami” shpk nuk ka paraqitur Certifikatën ISO 50001-2011, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 14.

- Referuar Ftaurës Tatimore me Nr. 287 datë 01.06.2016; Faturës Tatimore me Nr. 336 datë 24.06.2016 si dhe Faturës Tatimore me Nr. 549 datë 10.01.2017 të paraqitura nga shoqëria “Bami” shpk rezulton se ky Operator ekonomik disponon 33 (tridhjetë e tre) kokore dhe jo 100 (njëqind) kokore ashtu siç përcaktohet në DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15.
- Sa më sipër, Operatori ekonomik “Bami” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik për objektin që prokurohet, pasi nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Geci” shpk**, me adresë: **Tirana International Hotel, Sheshi Skënderbej, Nr.8, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **270,931,893.75** (dyqind e shtatëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 24.01.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.